



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Tiranë, më __.10.2020

RELACION

Për llogaritjen e mandatit të Anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë

KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË

Anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga radhët e avokatisë, trupa e pedagogëve dhe nga Shoqeria Civile janë zgjedhur me vendim të Kuvendit të Shqipërisë nr.19/2018, datë 08.02.2018, në zbatim të parashikimeve të nenit 147, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 35 të ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar. Vendimi në fjalë i Kuvendit, ka konsideruar të zgjedhur kandidatët e listës së tretë në bllok për anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, listë që ka rezultuar nga hedhja e shortit në nënkomisionin “Për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, për shkak të mosarritjes së shumicës prej dy të tretave të votave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit. **Ky vendim është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 19, datë 14.02.2018.**

Asambleja e Përgjithshme e Prokurorëve, pas përfundimit të procedurave të rivlerësimit kalimtar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, për të gjithë kandidatët prokurorë të cilët garonin për anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga radhët e sistemit të prokurorëve, në datë 12 Dhjetor 2018, në mbështetje të nenit 149, pikat 2 dhe 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, neneve 111 dhe vijues të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, është mbledhur përmes një rregulloreje specifike për votimin dhe zgjedhjen e 6 anëtarëve prokurorë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, procedurë për të cilën ka mbajtur të dokumentuar etapat e ndjekura. **Vendim nr. 3152/4 dt.12.12.2018 i Asamblesë së Përgjithshme të Prokurorëve, i cili ka zgjedhur anëtarët prokurorë për në KLP, është botuar edhe në Fletoren Zyrtare 176/2018.**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë u krijua pas zgjedhjes së anëtarit të fundit nga autoritetet përkatëse, në këtë rast ishte anëtari prokuror i fundit i votuar nga Asambleja e Përgjithshme e Prokurorëve, që u bë pjesë e KLP-së.

Në zbatim të neneve 149 dhe 179, pika 6 të Kushtetutës si dhe nenit 280 të ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, me vendimin nr. 1, datë 19.12.2018 Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka mbajtur mbledhjen e parë, gjatë të cilës është deklaruar krijimi i këtij organi të pavarur kushtetues, duke zgjedhur në po të njëjtën datë, Kryetarin dhe nënkryetarin e këtij institucioni.

Sipas pikës 17 të nenit 35 të ligjit 115/2016, vendimi i Kuvendit për miratimin e listës së kandidatëve botohet në numrin më të parë të Fletores Zyrtare. Akti në fjalë është miratim në bllok i kandidatëve, i lidhur specifikisht me përgjegjësinë kushtetuese parashikuar në nenin 149, pika 2 të Kushtetutës, e cila ngarkon Kuvendin me përgjegjësinë e zgjedhjes së anëtarëve joprokurorë në Këshillin e Lartë të Prokurorisë.

E njëjta dispozitë kushtetuese, neni 149 pika 10, parashikon shprehimisht se, anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë e ushtrojnë detyrën me kohë të plotë për një periudhë prej pesë vjetësh, pa të drejtë rizgjedhjeje të njëpasnjëshme, pra, mandati lidhet me ushtrimin e detyrës me dy kriteret e ligjit: (a) për vetëm 5 vjet dhe (b) me kohë të plotë.

Efektshmëria e ushtrimit të këtij funksioni, pra të anëtarit të KLP-së, garantohet nga angazhimi në detyrë me kohë të plotë, sikundër parashikohen situatat e papajtueshmërisë nga neni 149/ç i Kushtetutës.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë nga ana tjetër, rezulton të ketë filluar veprimtarinë e tij efektive, pra në përmbushje të kompetencave të dhëna nga Kushtetuta dhe ligjet specifike, vetëm në datë 19.12.2018, me vendimin nr.1 "Për krijimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë". Momenti i krijimit është parashikuar në ligj, dhe lidhet me ditën kur anëtari i fundit i KLP-së zgjidhet nga autoritetet kompetente. Koha e vendosur nga ligji për konstituimin e KLP-së, (e lidhur me zgjedhjen e anëtarëve të tij nga radhët e prokurorëve), u kushtëzua nga zgjedhja e kandidatëve nga Asambleja e Përgjithshme e Prokurorëve vetëm në datë 11.12.2018, pas përfundimit të procesit të rivlerësimit kalimtar prej tyre, me konfirmim në detyrë.

Efektet e vendimit të Kuvendit të Shqipërisë nr.19/2018 kanë filluar menjëherë sapo ky vendim ka marrë formë të prerë, por vetëm të lidhura me vullnetin e këtij organi për të emëruar në këtë funksion kandidatët që do të ishin anëtarë jo-prokurorë nga radhët e KLP-së dhe jo me fillimin e ushtrimit të mandatit si anëtarë të KLP-së ndërkohë që vet organi kushtetues nuk ishte krijuar.

Afati 5 vjeçar i mandatit të ushtrimit të këtij funksioni nga ana tjetër, ka filluar të ecë ditën e konstituimit të KLP-së, pasi vetëm kjo e fundit garanton ushtrimin efektiv dhe me kohë të plotë të detyrës së anëtarit të Këshillit. Argumentin e jep vetë Kushtetuta e RSH-së, e cila shprehet se, anëtarët e KLP-së e ***ushtrojnë detyrën*** me kohë të plotë për një periudhë prej pesë vjetësh. Pra, jo emërimi në detyrë, por **ushtrimi i detyrës shënjon fillimin e afatit kushtetues apo mandatin si anëtar i KLP-së.**

Vetë Kushtetuta, - në artikullimin e rrethanës që passjell papajtueshmëri me detyrën si anëtar i KLP-së -, citon "***qenien***" anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe jo zgjedhjen si i tillë. Pra qenia anëtar, prezumon ushtrimin konkret të detyrës si anëtar, e lidhur kjo e fundit me konstituimin e Këshillit. Për analogji, në fund të pikës 10 të nenit 149 të Kushtetutës, prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme në KLP, u pezullohet mandati i prokurorit, gjatë kohës që ***ushtrojnë funksionin*** si anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Për analogji, edhe në rastin e mandatit të deputetit, KQZ bën shpalljen e mandatit të fituar, ndërkohë që fillimi i ushtrimit të tij bëhet në momentin kur pushon mandati i të zgjedhurve të legjislaturës së mëparshme dhe mandati i çdo deputeti zyrtarizohet në mbledhjen e parë të parlamentit.

Koha e fillimit të mandatit nga anëtarët e KLP-së, është logjiksht e lidhur me ushtrimin prej tyre të funksionit efektiv, dhe kjo mund të bëhej vetëm me konstituimin e Këshillit.

Në mbledhjen e parë të Këshillit, është hedhur shorti sipas nenit 179, pika 6 e Kushtetutës, ku janë përcaktuar mandate 3 dhe 5 vjeçare të anëtarëve të Këshillit.

Mandatet e Anëtarëve janë si në tabelën më poshtë:

Emri	Pozicioni	Kohëzgjatja e mandatit	Institucioni ku ka patur emërimin	Vakanca në KLP
Gent Ibrahimimi	Kryetar	3 vjet	Trupa e pedagogëve të fakulteteve të drejtësisë dhe të Shkollës së Magjistraturës	-----
Alfred Balla	Zv. Kryetar	5 vjet	Përfaqësues nga shoqëria civile	----- -
Bujar Sheshi	Anëtar	5 vjet	Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit të Krimeve të Rënda Tiranë	----- -
Esmeralda Cami (zëvendëson G. Osmani)	Anëtar	5 vjet	Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër	----- --
Kostaq Beluri	Anëtar	3 vjet	Prokuroria e Pëgjithshme	----- --

Nurihan Seiti Metaj	Anëtar	5 vjet	Përfaqësuese nga radhët e avokatëve	----- --
Sander Beci	Anëtar	3 vjet	Trupa e pedagogëve të fakulteteve të drejtësisë dhe të Shkollës së Magjistraturës	----- --
Tartar Bazaj	Anëtar	5 vjet	Përfaqësuese nga radhët e avokatëve	----- --
Vatë Staka (zëvendëson A. Sevdari)	Anëtar	3 vjet	Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër	----- ---
Besnik Cani (vend vakant)	Ish-anëtar	5 vjet	Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan	Vendim i KLP nr. 76, datë 04.03.2020, "Për mbarimin e mandatit të anëtarit të KLP"
Arben Dollapaj (vend vakant)	Ish-anëtar	3 vjet	Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Shkodër	Vendim i KLP nr. 90, datë 25.03.2020, "Për mbarimin e mandatit të anëtarit të KLP"

Sqarim sa i takon të dhënave në tabelën më lartë:

Ndërkohë, për shkak shkarkimesh nga procesi i rivlerësimit kalimtar të dy prej anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Asambleja e Përgjithshme e Prokurorëve është mbledhur edhe dy herë të tjera respektivisht:

- Më datë 11.04.2019, Asambleja e Përgjithshme e Prokurorëve është rimbledhur për të zgjedhur një anëtar të ri mbas shkarkimit nga detyra të Znj. Antoneta Sevdari nga KPA. Në këtë votim fitues është shpallur kandidati i vetëm Z. Vatë Staka. Vendim ky që është publikuar ne FZ 50/2019.
- Më datë 04.10.2019, Asambleja e Përgjithshme e Prokurorëve është rimbledhur për të zgjedhur një anëtar të ri mbas shkarkimit nga detyra të Z. Gentajan Osmani nga KPA. Në këtë votim fitues është shpallur kandidatja Znj. Esmeralda Keshi (Cami). Vendim ky që është publikuar ne FZ 138/2019

Në përfundim, si fillim i afatit të mandatit të anëtarëve do të llogaritet data 19.12.2018, datë në të cilën është krijuar Këshilli si dhe ka filluar ushtrimi i detyrës nga ana e anëtarëve. Për anëtarët me mandat 3 vjeçar si afat i përfundimit të mandatit do të jetë dt. 18.12.2021 ndërkohë që për anëtarët me mandate 5 vjeçare afat përfundimi do të jetë dt.18.12.2023

Bashkëlidhur projekt-vendimi për miratim.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETARI

GENT IBRAHIMI

